

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE
ME SELI NË ELBASAN

FREE ZONE CONSULTING SH.P.K

Sot, më 18/05/2022 (dymijë e njëzetë e dy), ortakët themelues:

Shoqëria tregtare Quadruple-A SHPK, person juridik shqiptar i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër identifikimi nipt L81322041P, me seli të regjistruar në adresën Rruga Muhamet Gjollësja, Godina Qendra Tregtare Ring, Hyrja 2, Apartamenti 14, Tiranë, përfaqësuar sipas vendimit të Ortakut të Vetëm, datë 09.05.2022 nga ana e Administratores Znj. Ira Hysaj shtetase shqiptare, e datëlindjes 21.03.1994, lindur në Golem, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e kartës së identitetit me nr 032686384 dhe nr personal J45221087Q;

Elton Belba shtetas shqiptar, i datëlindjes 16.06.1975, lindur dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër 034018112 dhe nr. Personal H50616160U.

Maksim Haxhia i biri i Rustemit dhe i Rukies, i datëlindjes 03.05.1958, lindur në Gjirokastrë dhe banues në Tiranë në adresën Rruga e Elbasanit, Kompleksi Zibraku, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër 034813075 dhe nr. Personal F80503035M


Artan Hajdari, i biri i Rrapit, i datëlindjes 17.12.1968, lindur në Patos dhe banues në Tiranë në adresën Rruga e Elbasanit, Kompleksi Zibraku, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 035753503 dhe numër personal G81217022Ë.

Eris Hysi, e bija e Shabanit, e datëlindjes 28/05/1979, lindur në Rrëshen, Mirditë dhe banuese në Tiranë në adresën Rruga Maliq Muca, Pallati 46, Shkalla 3, Ap. 2, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e kartës së identitetit me numër 033750732 dhe nr personal H95528223O.

Të cilët kanë vendosur të themelojnë shoqërinë “Free Zone Consulting” **SH.P.K.** me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare “Free Zone Consulting” **SH.P.K.** themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (këtu e më poshtë “Shoqëria”).



Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

NENI 2

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin juridik-civil me emërtimin e saj “Free Zone Consulting” SH.P.K. Shoqëria mund të dalë në qarkullimin juridiko civil dhe me shkurtimin e emërtimit të saj FZC Sh.p.k.. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt aktivitetet e mëposhtme:

- Konsulenca në administrim të aktiviteteve të ndryshme ekonomike;
- Promovim të aktiviteteve në një Zonë së Lirë Ekonomike;
- Dhënia e konsulencave ligjore të të gjitha llojeve;
- Dhënia e konsulencave financiare të të gjitha llojeve shërbime që do të përfshijnë por nuk do të kufizohen në *Shërbime kontabël; Konsulencë për aktivitetet tregtare; analiza financiare; etj*
- Gjithashtu shoqëria do të kryejë veprimtari seleksionimi dhe formimi; veprimtari ndërmjetësimi dhe përfaqësimi, etj.

NENI 4

Selia e Shoqërisë


Selia e Shoqërisë ndodhet në Elbasan në adresën Lagjia Skenderbej, Zona Industriale Jug, Elbasan, Shqipëri. Ndryshimi i selisë brenda të njëjtës bashki apo hapja e selive sekondare mund të bëhet me vendim të organit administrativ dhe nuk do të sjellë ndryshimin e statutit.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është **1000** (lekë)dhe përbëhet nga kontributi i ortakëve themelues. Kapitali i shoqërisë është i ndarë mes Ortakëve të shoqërisë sipas pjesëmarrjes si vijon:

1. Z. Elton Belba mbajtës i 1 (një) kuotë që përfaqëson 34% te kapitalit themeltar të shoqërisë në vlerën prej 340 lek;
2. Shoqëria Quadruple - A mbajtës i 1 (një) kuote që përfaqëson 33 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, në vlerën prej 330 lek.
3. Z. Maksim Haxhia, mbajtës i 1 (një) kuote që përfaqëson 11.55 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, në vlerën prej 115.5 lek.



4. Z. Artan Hajdari, mbajtës i 1 (një) kuote që përfaqëson 11.55 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, në vlerën prej 115.5 lek.
5. Znj. Eris Hysi, mbajtëse i 1 (një) kuote që përfaqëson 9.9 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, në vlerën prej 99 lek.

Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit të shoqërisë është kryer nga ortaku me miratimin e këtij statuti.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është për një periudhë të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit pranë organeve kompetente dhe mund të ndryshohet me vendim të ortakëve sipas statutit.

Neni 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë.

Administratori i parë i shoqërisë do të jetë:

Elton Belba shtetas shqiptar, i datëlindjes 16.06.1975, lindur dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër 034018112 dhe nr. Personal H50616160U


Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ortaku themelues mund të vendosë me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 9

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.



NENI 10

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 11

Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortaku themelues, në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

NENI 12

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve apo ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë zgjidhen nga ortaku themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Dispozita Përfundimtare


Akti i themelimit përpilohet në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKET THEMELUES

Quadruple-A SHPK

Përfaqësuar nga

Ira HYSAJ



Elton BELBA

Artan HAJDARI

Maksim HAXHIA

Eris HYSI